



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 140 Prot.

Tiranë, më 12.092017

VENDIM Nr. 175, datë 05.09.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, datë 05.09.2017, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën e Fushë Peshtanit KM 137 + 350, Berat, në kuadër të *projektit të Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)* -subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonën e Fushë Peshtanit KM 137 + 350, Berat, në kuadër të *projektit të Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)* -subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Shoqëria e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., të marrë masat për konservimin dhe ruajtjen *in situ*, të Sitit arkeologjik të zbuluar gjatë gërmimit arkeologjik të shpëtimit të sipërpërmendur dhe rehabilitimin e zonës.
3. Të kryhet devijimi i Linjës së tubacionit të Gazsjellësit TAP drejt jugut, duke ju larguar sa të jetë e mundëshme Silit arkeologjik, i cili do të ruhet *in situ*, por brenda kufive të parashikuar. (RoW).
4. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazjellësit TAP, duke u kryer ndjekja në mënyrë periodike ditore e punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 40, datë 24.03.2017, për projektin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e III (KM 69 - KM 139,674).
5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.



6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTRE



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO